



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR
TË GJIMNAZIT**

FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE

LËNDA: EKONOMI

KODI: 8.4.12.ZA

PROGRAMI I AVANCUAR I LËNDËS EKONOMI

PËR KLASËN E 12-të

TIRANË, PRILL 2010

Kuptimi i bazave të ekonomisë është i domosdoshëm për të kuptuar ngjarjet ekonomike dhe ndryshimet në ekonominë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërkohë individët dhe komunitetet janë duke u përpjekur që të adaptojnë ndryshime strukturore në shoqëri, që burojnë nga ndikimet e ndryshimeve teknologjike dhe konkurrenca e bashkëpunimi ndërkombëtar.

Është shumë e rëndësishme që nxënësit të marrin vendime në jetën e tyre, të jenë pjesëmarrës aktive në një ekonomi globale, anëtare produktivë të forcës së punës dhe qytetarë të përgjegjshëm, si dhe promotorë të sistemit të sipërmarrjes së lirë.

Mendimi ekonomik ose "mënyra ekonomike e të menduarit" është një produkt themelor i studimit të lëndës së ekonomisë. Një mendim i tillë kritik i përgatit nxënësit të analizojnë dhe të peshojnë jo vetëm efektet afatshkurta të vendimmarrjeve të tyre, por gjithashtu edhe efektet e tyre afatgjatë dhe më tej edhe rrjedhojat që këto vendime sjellin.

Lënda e ekonomisë së avancuar u ofron nxënësve një kuadër vital brenda të cilave nxënësit mund të marrin vendime ekonomike personale, analizojnë çështje dhe politika publike aktuale dhe kuptojnë e analizojnë marrëdhëniet komplekse midis sistemeve kulturore, politike dhe ekonomike.

Përvetësimi i parimeve të përgjithshme të mendimit ekonomik synon krijimin tek nxënësit të njohurive, shprehive dhe qëndrimeve e vlerave ekonomike që janë në përshtatje me kërkesat e kornizës kurrikulare kombëtare. Përvetësimi i njohurive të ekonomisë së avancuar do të ndihmojë në ndërgjegjësimin e nxënësve mbi rolin e tyre si agjentë ekonomikë, si politikë-bërës dhe vendim-marrës aktivë të çështjeve ekonomike.

Realizimi i përmbajtjes së lëndës, konkretizohet me shembuj, ilustrime dhe nëpërmjet ushtrimit praktik të nxënësve në rolin e tyre si prodhues, si shitës të produkteve, si taksapagues, si zotërues burimesh materiale, si votues, ata delegojnë kompetencat, si konsumatorë, si kursimtarë dhe investitorë. Kësisoj nxënësit aftësohen për të punuar në grup, për të ndërmarrë veprimtari nxitëse, fokusohen në situata konkrete, trajtojnë koncepte, fakte dhe situata ekonomike, bëjnë analiza dhe arrijnë në përfundime konkrete.

1. SYNIMI I LËNDËS

Lënda e ekonomisë së avancuar synon që nxënësit:

Duke zbërthyer më thellë konceptet ekonomike dhe duke studiuar ndërlidhjen midis tyre, të kenë një kuptim më të plotë të qëllimeve kryesore sociale, të cilat shërbejnë për të vlerësuar performancën dhe politikat ekonomike, të marrin vendime të rëndësishme dhe efektive ekonomike duke zëvendësuar gjykimin emocional me analizën ekonomike dhe të argumentuar si dhe duke marrë një kuadër konceptual, ndërlidhës dhe argumentues, të organizojnë të kuptuarin e tyre ekonomik dhe të ekspozojnë një mënyrë të menduarit sistematik, argumentues dhe objektiv.

Kjo do t'i ndihmojë ata të zhvillojnë aftësitë e tyre për të interpretuar problematikën ekonomike në situata të reja të zhvillimit ekonomiko-shoqëror, të zhvillojnë përkushtimin e vazhdueshëm në trajtimin e çështjeve ekonomike dhe të pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e qytetarisë, si dhe të zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësinë për të ndjekur problematikën ekonomike në perspektiva të reja të zhvillimit shoqëror.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:

- të krahasojë dhe analizojë sistemet ekonomike mbi bazën e kritereve të efikasitetit, lirisë ekonomike, rritjes ekonomike, etj;
- të analizojë ndërveprimin e forcave të tregut në përcaktimin e çmimeve të mallrave dhe faktorëve të prodhimit;
- të shpjegojë faktorët që ndikojnë në elasticitetin në kërkesë dhe ofertë, duke analizuar raste të tregut real;
- të argumentojë funksionimin e tregjeve dhe ndërveprimin e tyre;
- të analizojë efektet që krijohen në ekonomi si rezultat i ndërveprimit të tregjeve të mallrave dhe të faktorëve të prodhimit;
- të shpjegojë faktorët që çojnë në rritjen e prodhueshmërisë dhe ndikimin që kanë në standardin e jetesës së një vendi, funksionimin e tregut të punës si dhe marrëdhëniet ndërmjet qeverisë, punës, konkurrencës në sistemin e sipërmarrjes së lirë;
- të analizojë strukturat e tregut dhe efikasitetin e tyre në një ekonomi tregu;
- të shpjegojë funksionet dhe domosdoshmërinë e rolit të qeverisë në një ekonomi tregu dhe rolin e Bankës Qendrore në hartimin e politikave monetare e efektet e tyre në stabilizimin e ekonomisë;
- të analizojë prirjet e zhvillimit ekonomik të vendeve, bazuar në analizën e treguesve kryesorë ekonomikë si GBP, normës së inflacionit, papunësisë etj;
- të analizojë politika ekonomike të qeverisë për stabilizimin e ekonomisë si dhe proceset integruese të bashkëpunimit ekonomik midis vendeve;
- të shpjegojë se si zhvillimi ekonomik ndikon në mirëqenien e popullsisë si dhe sfidat globale të së ardhmes të zhvillimit ekonomik të botës;
- të zotërojë terminologjinë e avancuar që përdorin ekonomistët;
- të demonstrojë mendimin kritik dhe aftësinë vendimmarrëse efektive.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

KLASA 12

34 javë x 2 orë = 68 orë

LINJA: EKONOMIA E TREGUT

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë fokusohet në thellimin tek nxënësi të koncepteve dhe arsyetimeve ekonomike mbi vendimmarrjen në kushtet e burimeve të kufizuara ekonomike. Nëpërmjet kuptimit dhe analizës së këtij fakti, krijohet një kuptim i thellë ekonomik mbi idenë se të gjitha zgjedhjet ekonomike shoqërohen me një kosto.

Nxënësit vlerësojnë dhe analizojnë qëllimet sociale të një ekonomie, veprimin kompleks të ligjit të kërkesës dhe ofertës në ekonominë e tregut dhe pajisen me mjetet e analizës që ata mund t'i përdorin edhe në linjat e tjera. Gjithashtu, ata njihen e diskutojnë mbi

sjelljen konsumatore dhe maksimizimin e dobishmërisë marxhinale dhe bëjnë një analizë krahasuese të strukturave të tregut, të parimeve mbi të cilat bazohet vendimmarrja e firmave në nivele të ndryshme të konkurrencës së tregut.

Orët e sugjeruara¹ : 35

Nënlinja	Objektivat
<p>1.1. Qëllimet sociale të një ekonomie (3 orë)</p>	<p><i>Në përfundim të këtij programi nxënës/i, -ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë duke i listuar objektivat sociale të një ekonomie; ▪ të krahasojë sistemet ekonomike bazuar në kriteret dhe qëllimet sociale; ▪ të analizojë dhe vlerësojë mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike plotësojnë qëllimet kryesore ekonomike.
<p>1.2. Kërkesa dhe oferta: si funksionojnë tregjet (8 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë elasticitetin e kërkesës dhe të ofertës në lidhje me çmimin; ▪ të llogaritë koeficientin e elasticitetit të kërkesës dhe të ofertës në lidhje me çmimin duke nxjerrë konkluzione bazuar në të; ▪ të identifikojë mallra elastike, jo elastike në kërkesë dhe ofertë. ▪ të analizojë faktorët që ndikojnë në elasticitetin në kërkesë dhe ofertë; ▪ të interpretojë lakoren e mallrave elastike, jo-elastike dhe me elasticitet njësi, në kërkesë dhe ofertë. ▪ të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar; ▪ të shpjegojë lloje të tjera elasticiteti, si elasticiteti i kërkesës lidhur me të ardhurat dhe elasticiteti i tërthortë i kërkesës dhe si ndërveprojnë tregjet e produkteve dhe të faktorëve të prodhimit me njëri-tjetrin;

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor në këtë lëndë. Quhen të sugjeruara, sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit), që të shtojë, ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10%, sipas nevojave të klasës

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë pasojat e ndryshimeve në kërkesë dhe ofertë për një produkt, faktorë të caktuar prodhimi, që vijnë si rezultat i ndryshimeve që pësojnë hap pas hapi produkte dhe faktorë të tjerë prodhimi; ▪ të analizojë efektet e politikave të ndryshme qeveritare mbi kontrollin e çmimeve në një ekonomi.
<p>1.3. Sjellja konsumatore dhe maksimizimi i dobishmërisë (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të interpretojë dobishmërinë marxhinale zbritëse dhe ligjin e dobishmërisë marxhinale zbritëse; ▪ të ndërtojë dhe argumentojë lakoret e indiferencës dhe të gjejë ekuilibrin e konsumatorit; ▪ të argumentojë maksimizimin e dobishmërisë në përndarjen e të ardhura në para; ▪ të bëjë zgjedhje racionale në shpenzimin e të ardhurave në para të kufizuara, bazuar në preferenca të mirë përcaktuara; ▪ të argumentojë zgjedhjet e bëra si individ konsumator në përndarjen e të ardhurave.
<p>1.4. Sipërmarrës i suksesshëm. Si të bëhesh i tillë (5 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë si mund të bëhesh sipërmarrës i suksesshëm; ▪ të interpretojë konceptin e sipërmarrjes dhe të sipërmarrësit dhe tiparet, cilësitë e sipërmarrësve; ▪ të analizojë dhe të vlerësojë veprimtari sipërmarrjesh/sipërmarrësish; ▪ të analizojë sfidat dhe përfitimet e sipërmarrjes së lirë; ▪ të diskutojë mbi strategjitë që përdorin sipërmarrës të ndryshëm për të arritur suksesin e tyre; ▪ të analizojë përparësitë dhe disavantazhet e biznesit të vogël dhe për të konkluduar në rolin që ka ky biznes në sistemin e ekonomisë së tregut. ▪ të analizojë etikën e sipërmarrësve, format e promovimit dhe të ballafaqimit me konsumatorin në treg.
<p>1.5. Prodhimi, produktiviteti dhe tregu i punës (8 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë funksionin e prodhimit në periudhën afatshkurtër/afatgjatë dhe pse ka rënie prodhimi në periudha afatshkurtër; ▪ të analizojë vendimmarrjet e bizneseve mbi prodhimin në periudhën afatgjatë/afatshkurtër; ▪ të llogarisë prodhueshmërinë dhe japë kuptimin e saj;

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të bëjë dallimin midis prodhimit dhe prodhueshmërisë; ▪ të analizojë faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri dhe efektet që kanë ato në standardin e jetesës së vendit. ▪ të shpjegojë funksionimin e tregut të punës; ▪ të analizojë përcaktimin e pagave për kategori të ndryshme pune si dhe veprimin e forcave jashtë tregut në vendosjen e pagave; ▪ të analizojë zhvillimet e fundit në marrëdhëniet punë – menaxhim.
<p>1.6. Analizë krahasuese e strukturave të tregut dhe rregullimi i monopolit (5 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të përcaktojë nivelin e prodhimit në të cilën firmat maksimizojnë fitimin në struktura të ndryshme tregu; ▪ të analizojë vendimmarrjet e firmave në struktura të ndryshme tregu si dhe sjelljet e firmave në struktura të ndryshme tregu si në periudhën afatshkurtër dhe në periudhën afatgjatë; ▪ të analizojë efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin. ▪ të analizojë dhe argumentojë domosdoshmërinë e politikave shtetërore mbi kontrollin e monopolit.

LINJA2: EKONOMIA KOMBËTARE

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë fokusohet në thellimin e të kuptuarit mbi rolin e qeverisë në një ekonomi dhe identifikimin e disa problemeve me të cilat, përballet qeveria në realizimin e funksioneve të saj ekonomike. Në këtë linjë instrumentet e analizës marxhinale do të lejojnë nxënësit të bëjnë një diskutim më të plotë dhe më të thellë të shërbimeve publike dhe eksternaliteteve si dhe zbatimit të politikave fiskale të qeverisë për zgjidhjen e problemeve ekonomike.

Orët e sugjeruara: 25

Nënlinja	Objektivat
<p>2.1. Roli i qeverisë në ekonomi, një vështrim i gjerë (5 orë)</p>	<p><i>Në përfundim të këtij programi nxënës/i, -ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të argumentojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. ▪ të analizojë rritjen e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi si dhe efikasitetin e përdorimit të burimeve të alokuara në sektorin publik; ▪ të analizojë disa nga problemet me të cilat përballet

	<p>qeveria në realizimin e veprimtarisë së saj ekonomike si dhe politika të ndryshme të qeverisë mbi ligjet antimonopol, zhvillimin dhe mbështetjen e sektorit privat, reduktimin e varfërisë, ndotjen e mjedisit etj;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë ndikimin e taksimit dhe vendimmarrjet e qeverisë për politika sociale ndaj subjekteve të veçanta.
<p>2.2. Politika monetare dhe mekanizmi i transmissioinit (8 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë komponentët e ofertës monetare dhe përbërësit e tyre dhe se si krijon para sistemi bankar duke dhënë kredi; ▪ të analizojë objektivat, qëllimet dhe instrumentet e politikës monetare; ▪ të shpjegojë instrumentet bazë monetare dhe përdorimin e tyre; ▪ të analizojë efektin e instrumenteve monetare në stabilizimin e çmimeve, rritjen ekonomike; ▪ të shpjegojë si Banka Qendrore rregullon ofertën monetare për të nxitur punësimin dhe stabilitetin e çmimeve; ▪ të argumentojë përgjegjësitë e qeverisë në stabilizimin e vlerës së njësisë monetare, që përfshin aplikimin e një politike fiskale dhe kontrolli efektiv mbi ofertën e parasë; ▪ të vlerësojë se si funksionon politika monetare (anët e forta dhe dobësitë e politikës monetare).
<p>2.3. Njohuri të thelluara makroekonomike (12 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë kuptimin e GDP për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante; ▪ të shpjegojë thelbin e metodës së prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave në matjen e produktit të përgjithshëm dhe të llogaritë produktin e përgjithshëm sipas metodës së shpenzimeve, të të ardhurave dhe të prodhimit. ▪ të shpjegojë kërkesën tërësore dhe faktorët që ndikojnë në të. ▪ të krahasojë modelin makroekonomik klasik dhe kejnsonian të ekuilibrit. ▪ të llogarisë normën e inflacionit dhe normën e papunësisë; ▪ të analizojë raportin midis papunësisë dhe inflacionit si dhe lidhjen e përgjithshme makroekonomike, nëpërmjet agregimit të treguesve ekonomike.

LINJA 3: MARRËDHËNIET EKONOMIKE NDËRKOMBËTARE

Përshkrimi i linjës: Vendet dhe ekonomitë e tyre po ndërveprojnë dhe ndërlihen gjithnjë e më shumë me njëra tjetrën duke pasur përfitime. Zbërthimi i thelbit të tregtisë së lirë, proteksionizmit dhe proceseve të tjera integruese ekonomike midis vendeve, do t'i ndihmojë nxënësit të analizojnë më mirë ndërvarësinë globale ekonomike të vendeve dhe përfitimet që ato kanë.

Orët e sugjeruara: 8

Nënlinja	Objektivat
3.1. Bashkëpunimi ekonomik dhe proceset integruese (4orë)	<p><i>Në përfundim të këtij programi nxënës/i,-ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë thelbin e bashkëpunimit ekonomik midis vendeve si dhe hapat e proceset integruese në këtë bashkëpunim ekonomik; ▪ të analizojë përfitimet e vendeve nga ky bashkëpunim dhe integrim ekonomik si dhe ecurinë e tregtisë me jashtë të vendit tonë në kushtet e integritimit ekonomik në rajon dhe Evropë; ▪ të shpjegoje MTL, MSA, dhe përfitimet reciproke të vendeve që zbatojnë këto marrëveshje; ▪ të analizojë pozicionin dhe nivelin e përfshirjes së Shqipërisë në këtë proces integrues ekonomik.
3.2. Zhvillimi ekonomik dhe varfëria (4orë)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë se mirëqenia e një vendi varet nga niveli i zhvillimit ekonomik të tij; ▪ të bëjë krahasimin e varfërisë absolute dhe relative, si domosdoshmëri për të analizuar nivelin e varfërisë reale të një vendi; ▪ të analizojë tregues të nivelit të varfërisë në vendin tonë dhe të nxjerrë konkluzione nga kjo analizë; ▪ të shpjegojë politika ekonomike të qeverisë mbi reduktimin e varfërisë duke konkluduar në efektin që ato kanë.

4. KËRKESAT NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Ekonomia	1. Matematika
Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i,-ja: - Të gjejë dhe të interpretojë ekuacionin e vijës

	<p>në plan.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të interpretojë pozicionet e ndryshme të drejtëzës në plan, në varësi të koeficientit këndor. - Të llogaritë dhe përdorë përqindjen në raste të ndryshme. - Të jetë i aftë për të llogaritur mesataren. - Të bëjë përlllogaritjen e përpjesëtimeve. - Të jetë i aftë për të llogaritur indekset në raste të ndryshme. - Të interpretojë tabela, grafikë e diagrama.
Ekonomia	2. Gjuha shqipe
Për të gjitha linjat/nënlinjat	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënës/i-ja: - Të analizojë dhe interpretojë tekste të ndryshme. - Të shprehë opinione, të arsyetojë, diskutojë, argumentojë dhe të debatojë në lidhje me probleme të ndryshme . - Të zhvillojë dialog, të dëgjojë me vëmendje. - Të bëjë prezantime duke përdorur teknika të ndryshme.
Ekonomia	3. TIK
Për të gjitha linjat/nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përdorë pajisje <i>Input/Autput-i</i>, CD, DVD, USB, disketa. - Të përdorë programe të ndryshme për punë të pavarura, për të krijuar tabela e paraqitje grafike dhe për të bërë prezantime të ndryshme (Word, Excel, Power Point), etj. - Të përdorë komunikimin elektronik (e-mail, rrjetin e brendshëm, Internetin, etj. për të komunikuar dhe bashkëpunuar me të tjerët. - Të përdorë Internetin dhe kërkimin në Internet për të gjetur materiale që do të shërbejnë për diskutime dhe analiza të ndryshme.
Ekonomia	4. Gjuhët e huaja (Anglisht dhe Frëngjisht)
Për të gjitha linjat/nënlinjat	<p>Nxënës/i-ja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të zotërojë fjalorin e domosdoshëm të përgjithshëm për të kuptuar dhe përkthyer materiale me përmbajtje ekonomike. - Të shfrytëzojë fjalorin terminologjik në gjuhë të huaj si: biznes (business), sipërmartje (enterprise), konsumator (consumer), treg

	(market), kërkesë (demand), ofertë (supply), papunësi (unemployment), inflacion (inflation), konkurrencë (competition), bankë (bank), kosto (cost), çmim (price), pamjafueshmëri (scarcity), etj.
Ekonomia	5. Historia
Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i-ja - Të përshkruajë koncepte bazë si: pronë private, sistem ekonomik, monopol, korporatë, buxhet qeveritar, etj. - Të përdorë njohuritë për periudha dhe ngjarje të ndryshme historike në ndihmë të shpjegimit të ndikimit që kanë pasur ato në ekonomi.
Ekonomia	6. Gjeografia
Për të gjitha linjat/nënlinjat	Nxënës/i-ja - Të përshkruajë koncepte bazë të tilla si: burime natyrore, burime njerëzore, eksport, import, papunësi, etj. - Të shpjegojë fenomenin e migrimit dhe ta përdorë në funksion të tregut të punës. - Të shfrytëzojë mjete mësimore si hartat, globin, etj.

4. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program zbatohet për 68 orë. Programi është një dokument zyrtar. Ai është vetëm një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e ekonomisë. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës së shkencave shoqërore. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit;
- synimeve të linjave ndër-kurrikulare;
- vlerësimit të nxënësit me notë;
- parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin programet lëndore që kanë trajtuar njohuri ekonomike në klasat paraardhëse.

Përdoruesit e këtij programi duhet të njohin gjithashtu dhe programet e tjera lëndore që trajtojnë njohuritë ekonomike në gjimnaz.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, racore, fetare, etj.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që t'i realizojnë ato. Realizimi i objektivave në kapituj ose në tema dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit. Kështu, për shembull, nëse programi i lëndës "Ekonomi e avancuar" kërkon që nxënës/i-ja të jetë i/e aftë të shpjegojë ndërveprimin e tregjeve dhe të efekteve të tyre, ose të analizojë nivelin konkurrencës së tregjeve në ekonomi kjo do të thotë, se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia ta realizojnë këtë objektiv. Për realizimin e këtij objektiv nxënësit duhet t'i jepet detyra, koha dhe mundësi të tjera që të mbledhë fakte për çështjen në fjalë dhe të bëjë interpretimin e tyre.

Objektivat nuk duhet të mbeten abstrakt, të pa realizueshëm e të pa matshëm. Nëse një mësues/ese nuk e bën këtë, kjo do të thotë se ai/ajo nuk e ka zbatuar programin lëndor lidhur me këtë objektiv.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi duhet të ketë të qartë nivelet e arritjes së një objektivit nga nxënës/i,-ja si më poshtë:

- Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar (nivel i ulët intelektual).
- Aftësia për të shpjeguar dhe për të krahasuar (nivel mesatar intelektual).
- Aftësia për të analizuar dhe vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual).

Për shembull, programi kërkon që nxënës/i-ja të jetë i/e aftë:

Të analizojë vendimmarrjet e bizneseve mbi prodhimin në periudhën afatgjatë/afatshkurtër.

Ky objektiv mund të arrihet në disa nivele:

Niveli bazë: Të përcaktojë nivelin e prodhimit në të cilën firmat maksimizojnë fitimin në struktura të ndryshme tregu.

Niveli mesatar: Të bëjë krahasimin e vendimmarrjeve të firmave në struktura të ndryshme tregu.

Niveli lartë: Të analizojë vendimmarrjet e firmave në struktura të ndryshme tregu.

Programi realizohet edhe nëpërmjet zbatimit të kërkesave didaktike. Mësuesi duhet të njohë dhe të kërkojë zbatimin e kërkesave bazë, si:

- Nxënës/i-ja dallon kundërshtitë në pikëpamje.
- Nxënës/i-ja shpjegon lidhjen ndërmjet një pikëpamjeje me pasojat që ka zbatimi i saj në praktikë.
- Nxënës/i-ja krijon qëndrimin e tij/saj për çështjen në diskutim, të mbështetur me argumente që mbajnë parasysh edhe argumentet e të tjerëve të ndryshme nga të vetat.

Së pari, mësues/i-ja duhet t'i krijojë çdo nxënës/i-eje mundësinë të shprehë arritjet e tij/saj në të gjitha nivelet. Kjo do të thotë se mësues/i-ja nuk duhet të paragjykojë si përfundimtare aftësitë e një nxënës/i-eje që arrin nivelin e parë, por t'i japë atij/asaj, me anë të pyetjeve të tjera, mundësinë të shprehet edhe në nivelet e tjera.

Së dyti, mësues/i-ja duhet të vlerësojë nxënës/in-en për nivelin e shprehur të arritjeve, pasi t'i ketë dhënë atij/asaj të gjitha mundësitë të shprehë aftësitë e veta.

Kujdes i veçantë duhet treguar në realizimin e objektivave që kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive intelektuale dhe sociale të nxënësve, si ato të debatit, diskutimit, punës në grup etj. Kështu mësuesi mund të japë si detyrë pyetje me nivel të ndryshëm vështirësie, në përputhje me interesa të ndryshme të nxënësve, të cilat mund të bëhen si pikënisje për diskutim dhe debat në klasë dhe, shpesh herë, duke i sjellë si probleme të komunitetit ku jetojnë, për ta bërë debatin më praktik dhe me më interes.

Orët mësimore

Programi avancuar i ekonomisë për klasën e 12- të gjimnazit është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësues/i-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së ekonomisë afërsisht 65% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 35% e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësues/i-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur ve re se nxënësit e tij, hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij/saj demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm të objektivave.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive-bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një linje/nënlinjë me njohuritë e linjave/nënlinjave paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja dhe në nënlinja, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij, ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht, gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të aftësive të posaçme lëndore, si: të maturit, të ndjekurit e udhëzimeve, të

zbatuarit e kushteve të sigurisë, të përdorurit e pajisjeve dhe aparateve shkencore, të shfrytëzuarit e të dhënave eksperimentale. Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj. Në përputhje me zhvillimet aktuale ekonomike dhe problemet e dala mësuesi mund të japë detyra dhe të organizojë diskutimin dhe debatin e tyre në klasë. Dhe, ky diskutim e debat, mund të zgjasë edhe më shumë se një orë mësimore.

Njëkohësisht, gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme, si aftësia e komunikimit, aftësia e menaxhimit të informacionit, aftësia e zgjidhjeve problemore, aftësia e të menduarit kritik dhe krijues.
- Aftësive që lidhen me veçoritë e lëndës.
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si: qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i-ja zhvillon vetë e ndihmon nxënësit që së bashku të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si: me shkrim, me gojë, me projekte, me përgatitje të maketeve, të modelimeve dhe simulimeve kompjuterike, punëve të laboratorit dhe eksperimenteve etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër por edhe në rrugë elektronike.

Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim, në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disaminutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënësve, tek ato një orëshe; teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënës/it-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi dhe informacioni të prindërit të progresit të nxënësve, është një koleksion i punimeve të tij/saj përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi/ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.

Zbatuesit e programit duhet të kenë parasysh se vlerësimi i nxënësve vetëm me teste është i pjesshëm dhe nuk jep informacion të plotë mbi atë se çfarë di dhe çfarë është në gjendje të bëjë nxënësi. Testet tradicionale, si ato me zgjedhje të shumëfishtë apo me përgjigje të shkurtër në fund të një blloku tematik ose kapitulli, nuk vlerësojnë dot se sa di nxënës/i,-ja të planifikojë e realizojë një eksperiment, të bëjë vërejtje dhe matje të sakta, të analizojë të dhënat dhe të nxjerrë përfundime.